



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ NAZMI RUSHITI “DIBËR.

Nr. 263 prot.

Peshkopi, më 08.01.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
TIRANË**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit:të ligjit nr.15/2017,datë 16.02.2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,të vendim të Këshillit të Ministrave nr. 554,datë 31.07.2019, “Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive datë si dhe Udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë ,menxhimin e burimeve njerëzore,përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,i ndryshuar

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale “ Nazmi Rushiti “ Dibër, ju njofton krijimin e vendit të lire : për pozicionin :

**-Mësimdhënës të teorisë dhe praktikës profesionale ,Drejtimi TIK,1(një mësimdhënës) zëvendësues
leje lindje në shkollën Peshkopi.**

A-Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1 – Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon ;

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon ;

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;(T.I.K)
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

B-Dokumentet e aplikimit

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomë/dëftesën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
- ✓ Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së,
brenda datës 15.01.2025

DREJTORI

Majlinda POÇI